

# INTEGRITETI



INTEGRITET DHE ETIKË

SEMPER VIGILE

> IPK.RKS-GOV.NET



**Partneritet evropian kundër korrupsionit**



FOTO: INTEGRITETI

**Arbër BEKA**  
Kryeredaktor

# 2013-ta vit i sfidave dhe i suksesit

**P**o e lëmë pas së bashku një vit të stërngarkuar me aktivitete prej të cilave shumë do të mbesin të shënuara për Inspektoratin Policor të Kosovës.

Nëse fillojmë në mënyrë kronologjike atëherë medoemos duhet cekur në radhë të parë përrurimin e objektit të rinovuar të IPK-së në prill të këtij viti.

Deri këtë vit punonjësit e IPK-së kanë ndërruar disa herë me radhë vendqëndrimin duke u ballafaquar me vështirësi në aspektin e marrëdhënieve me publikun dhe bashkëpunimit me qytetarë e natyrisht

Projekti i renovimit të objektit ka filluar vitin e kaluar për tu finalizuar këtë vit dhe ofron kushte më të mira për punë.

Përmirësimi i kushteve të punës për zyrtarët e IPK-së të vendosur tani në një objekt me një hapësirë prej rreth 2700 metra katrorë me 82 zyra, salla dhe hapësira të tjera për punë, është një prej faktorëve që do të ndikojë pozitivisht në përmbushjen e objektivave ligjore.

Ky vit shënoi edhe rritjen e numrit të zyrtarëve të IPK-së. Pas përfundimit të trajnimit bazik për më shumë se gjashtë muaj në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike, 15 hetuesit/inspektorët filluan angazhimet e tyre në IPK. Programi i trajnimit praktik për këta zyrtarë ishte risia tjetër e këtij viti. Menaxhmenti i IPK-së janë përkuajdesur që zyrtarët e rinj, përmes programit të

trajnimit praktik të jenë të gatshëm për të punuar të pavarur pas periudhës gjashtë mujore.

Trajtimi me prioritet i rasteve me elemente korruptive dhe reduktimi në maksimum i rasteve që janë në pritje ishte si synim i këtij viti e që është realizuar me sukses. Vlen të ceket edhe fuqizimi i bashkëpunimit me prokuroritë kompetente dhe fillimi i caktimit të

**Trajtimi me prioritet i rasteve me elemente korruptive dhe reduktimi në maksimum i rasteve që janë në pritje ishte si synim i këtij viti e që është realizuar me sukses**

prokurorëve që do të merren me rastet që trajton IPK-ja.

Nuk duhet lënë anash edhe shkëmbimi i përvojave me vendet evropiane me agjencitë simotra të mbikëqyrjes policore. IPK-ja këtë vit mori pjesë në disa konferenca dhe seminare të rëndësishme duke përfshirë këtu edhe ato të organizuara nga EPAC-u (European Partners Against Corruption).

Përderisa mbikëqyrja demokratike e institucioneve të sigurisë mbetet si një ndër parakushtet kryesore të një shteti modern të bazuar në respektimin e të drejtave të njeriut dhe vlerave demokratike, më mbetet të them në fund se sfida të reja na presin vitin që vjen.

Kryeredaktori

# 8-9

Partneritet  
evropian  
kundër kor-  
rupsionit



## PËRMBAJTJA

### KËNDI I KRYESHEFIT

POLICIA PARAQET BAROMETRIN  
MORAL TË SHOQËRISË, 4-5

### IT

IPK MË AFËR QYTETARËVE,  
6-7

# 20

Fuqizohet  
profesional-  
izmi në IPK



### INSPEKTIVE

ROLI DHE MISIONI I  
DEPARTAMENTIT TË  
INSPEKTIVEVE TË IPK-SË,  
14-17

### KONFERENCA

LAW TECH EUROPE  
CONGRESS 2013, 18-19

# 21

Konferencë  
rajonale



### BASHKËPUNIMI RAJONAL

KOMUNIKIMI STRATEGJIK  
PËR KOMUNIKIM TË  
SUKSESSHËM, 22

# 10-11

Programi  
i trajnimit  
praktik në  
IPK



### FOTO LAJME

#### PIKË SHITESË:

Mendimet, komentet,  
këndvështrimet e shprehura  
ose të përfshira në përmbajtje  
të këtij botimi nuk paraqesin  
medeomos politikat ose  
vështrimet zyrtare të IPK-së.



**Fitim Shishani**  
Kryeshef i IPK-së

FOTO: INTEGRITETI

# Policia paraqet barometrin moral të shoqërisë

**Inspektorati Policor i Kosovës - mekanizëm i pa zëvendësueshëm ne rritjen e integritetit të Policisë së shtetit tonë.**

**N**ë Republikën e Kosovës, përgjegjshmëria e policisë, si organ i rëndësishëm për sigurinë në vend, është e një rëndësie të veçantë, normalisht, për shkak të rolit që ka në shoqërinë tonë demokratike. Në shoqëritë e ndryshme, qofshin ato demokratike apo jo, ekzistojnë mekanizma të ndryshëm për mbikëqyrjen e punës së policisë. Në Kosovë, ky mekanizëm është Inspektorati Policor i Kosovës, i përbërë nga pesë departamente (i hetimeve, inspektiveve, i analizës së informacionit dhe ankesave, i testit të integritetit dhe ai i administratës). IPK-ja është tërësisht e pavarur nga policia në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Misioni ynë ligjor është që përmes veprimtarisë që zhvillojmë, qytetarëve t'ju garantojmë se policia po i ushtron kompetencat e saj në përputhje me ligjin dhe me standardet më të mira ndërkombëtare, dhe mbi të gjitha, të garantoj se po respektohen të drejtat dhe liritë themelore të individit të parapara me Kushtetutën tonë dhe aktet ndërkombëtare. Si mekanizëm mbikëqyrës, ne jemi të

vetëdijshëm se Policia paraqet barometrin moral të shoqërisë. Prandaj, një nga synimet tona është që Policia e Kosovës të reflektojë tiparet e shoqërisë sonë të hapur demokratike. Në demokraci, punonjësit e policisë janë vetëm në shërbim të Ligjit. Eprori i parë për policinë duhet të jetë ligji. Studimet e ndryshme që i janë bërë fushë-veprimtarisë policore, kanë treguar se kredibiliteti i një organizate policore mbi të gjitha varet nga integriteti i anëtarëve të saj. Prandaj, lufta kundër korrupsionit dhe dukurive tjera negative në radhët e policisë, duhet të jetë një motiv për çdo polici, pra edhe atë të Republikës së Kosovës në mënyrë që policia të jetë e shëndosh, me integritet dhe e besueshme për publikun.

Duhet ditur se sado e mirë dhe korrekte të jetë sjellja e policisë ndaj publikut, ajo nuk mund ta krijoj një besim dhe siguri tek qytetarët nëse nuk është e aftë të dominoj mbi krimin. Për më tepër, shpesh herë, për shkak të imazhit jo të drejtë të policisë në publik, shumë qytetarë e fajësojnë policinë për rritjen e krimeve dhe të prishjeve të rendit publik.

---

Si mekanizëm mbikëqyrës, ne jemi të vetëdijshëm se Policia paraqet barometrin moral të shoqërisë. Prandaj, një nga synimet tona është që Policia e Kosovës të reflektojë tiparet e shoqërisë sonë të hapur demokratike. Në demokraci, punonjësit e policisë janë vetëm në shërbim të Ligjit. Eprori i parë për policinë duhet të jetë ligji. Studimet e ndryshme që i janë bërë fushë-veprimtarisë policore, kanë treguar se kredibiliteti i një organizate policore mbi të gjitha varet nga integriteti i anëtarëve të saj. Prandaj, lufta kundër korrupsionit dhe dukurive tjera negative në radhët e policisë, duhet të jetë një motiv për çdo polici, pra edhe atë të Republikës së Kosovës në mënyre që policia të jetë e shëndosh, me integritet dhe e besueshme për publikun.

Edhe tek ne, në Kosovë, si në çdo vend tjetër të botës, policia është sot më e ekspozuar se kurrë. Prandaj, Inspektorati Policor i Kosovës, është një mekanizëm i pa zëvendësueshëm në rritjen e integritetit të policisë së shtetit tonë.

Misioni, organizimi, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Inspektoratit Policor, si mekanizëm mbikëqyrës janë të përcaktuara me ligj. Janë dy shtylla kryesore përmes së cilave, ne zhvillojmë aktivitetin tonë: hetimet dhe inspektimet. Detyra kryesore për ne sipas ligjit është: parandalimi, zbulimi, dokumentimi dhe hetimi i veprave penale të kryera nga punonjësit e Policisë së Kosovës pa dallim grade dhe pozite, gjatë ushtrimit të detyrës ose jashtë saj.

Pra, ligjdhënësi i jep kompetenca shumë të rëndësishme, Inspektoratit Policor të Kosovës, me qëllimin e vetëm që të siguroj një polici të përgjegjshme, demokratike dhe transparente. Puna jonë, materializohet me raporte të ndryshme inspektuese mbas çdo inspektimi të kryer qoftë ai i zakonshëm

apo i jashtëzakonshëm, si dhe me ngritjen e kallëzimeve penale mbas çdo hetimi, kur kjo rezulton me prova për kryerjen e një veprë penale nga punonjësit e policisë. Kur është fjala te inspektimet, ne japim edhe Rekomandimet tona për policinë. Rekomandimet çdo herë i japim reale dhe të arritshme për policinë. Sigurisht që, rekomandimet e tilla kanë vetëm një qëllim, që ta ndihmojnë policinë tonë në përmbushjen e misionit të tyre ligjor.

Inspektorati Policor i Kosovës për përmbushjen e misionit të vet ligjor bashkëpunon ngushtë me qytetarët që janë viktima apo dëshmitar të një sjellje të keqe të punonjësve të Policisë së Kosovës.

Ne punojmë vazhdimisht që të ruajmë besimin e qytetarëve përmes hetimeve të drejta dhe transparente.

*Fjalim i mbajtur nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së Fitim Shishani në konferencën "Fuqizimi i llogaridhënies në sektorin e sigurisë" të organizuar nga DCAF-i e mbajtur në Slloveni 22*

*– 26 shtator 2013*

# IPK më afër

Një ndër qëllimet strategjike të Inspektoratit Policor është edhe përqendrimi për të siguruar shërbim të mirë për qytetarët duke ofruar një shërbim të kompletuar, konciz e korrekt i cili kryhet me përkushtim e me mirësjellje. Në kuadër të kësaj, rreth dy vite më parë ka hyrë në funksion edhe një mënyrë shtesë e kontaktit të qytetarëve me IPK-në. Menaxhmenti i IPK-së disa herë publikisht e kishte thënë se përparesitë e teknologjisë informative do të përdoren për të ofruar një shërbim sa më cilësor për qytetarët. Kjo edhe u realizua në momentin kur qytetarëve iu ofrua mundësia e kontaktimit ose plotësim-it të ankesave online përmes ueb faqes së IPK-së: [ipk.rks-gov.net](http://ipk.rks-gov.net). Në ballinë të ueb faqes zyrtare, në anën e djathtë të saj është vendosur linku për ankesa i cili pasi të klikohet jep mundësinë qytetarëve për plotësimin e të dhënave të tyre lid-



FOTO: INTEGRITETI

VALBONA OSMANI, DREJTORESHË E DEPARTAMENTIT PËR ANALIZIMIN E INFORMACIONIT DHE MENAXHIMIN E ANKESAVE (DAIM-A)



qytetarëve të vendit shfrytëzojnë teknologjinë informative dhe kanë kompjuter të në shtëpitë e tyre ndaj ne kemi menduar edhe për këtë mundësi"- shprehet Osmani. Ajo shprehet se është e rëndësishme që qytetarët janë të njoftuar edhe për konfidencialitetin e trajtimit të informatave që arrijnë përmes ankesës online pasi që vetëm dy zyrtarë të lartë të IPK-së kanë qasje në bazën e të dhënave në të cilën pranoen këto ankesa: "Ne kemi menduar edhe për çështjen e konfidencialitetit të trajtimit të informacioneve andaj qasja në këto të dhëna i është dhënë vetëm dy zyrtarëve të lartë të IPK-së. Siguria në trajtimin



# Qytetarëve

Ankesat elektronike  
– mundësi shtesë  
fuqizimin e  
bashkëpunimit me  
qytetarë

e informacionit dhe kontakti i lehtë me IPK-në janë karakteristikat që përcjellin këtë projekt. Qytetarët siç duket akoma nuk janë të informuar aq sa duhet për këtë mundësi pasi që numri i ankesave të pranuaras përmes linkut të ueb-faqes nuk është edhe aq i madh” – theksoi Osmani për revistën “Integriteti”.  
Ndryshe në gjashtë mujorin e parë të 2013-ës, nga 469 ankesa sa janë trajtuar në IPK një numër i tyre është pranuar në mënyrë elektronike.



The screenshot shows the website of the Ministry of Internal Affairs and the Kosovo Police Inspectorate. The main heading is "Ministria e Punëve të Brendshme INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS". The page is in Albanian and features a navigation menu on the left with "Ankoho" highlighted. The main content area is titled "Ankoho" and contains a form for reporting an incident. The form includes fields for name, address, date, and phone number. A blue arrow points to the "Ankoho" menu item, and another blue arrow points to the "Ankoho" section of the form. Below the form, there is a calendar for December 2013 and a section for reporting an incident.





# PARTNERITET EVROPIAN KUNDËR KORRUPSIONIT

**K**ryeshefi Ekzekutiv i IPK-së – z. Fitim Shishani mori pjesë në Konferencën e 13-të me radhë të EPAC-ut (European Partners Against Corruption – Partnerët Evropian Kundër Korrupsionit) që u mbajt në Krakow të Polonisë më 13-15 nëntor 2013.

EPAC-u themelua në vitin 2004 me qëllim që të kontribuoj në fushën e mbikëqyrjes policore dhe luftës globale kundër korrupsionit.

EPAC-u në konferencën profesionale vjetore por edhe në punëtori tjera sjell së bashku mbi 65 organizata – institucione të mbikëqyrjes policore







## IPK në Konferencën e 13-të profesionale të EPAC-ut

dhe antikorrupsionit të shteteve evropiane duke përfshirë këtu edhe Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK).

Gjatë kësaj Konference profesionale ku Republika e Kosovës u përfaqësua nga Inspektorati Policor i Kosovës me dy delegatë, u diskutuan tema të rëndësishme për mbikëqyrjen policore dhe luftën kundër korrupsionit.

Konferenca profesionale vjetore e EPAC-ut solli së bashku rreth 100 delegatë në mesin e të cilëve edhe delegatët nga Inspektorati Policor i Kosovës.

Gjatë katër sesioneve plenare sa u mbajtën gjatë këtyre ditëve u trajtuan tema të rëndësishme si: rregulloret e integritetit brenda policisë, korrupsioni dhe luftimi i tij në shërbimet policore, testi i integritetit –korniza ligjore etj.

Prezantimet nga delegatët ngritën disa çështje të rëndësishme dhe aktuale siç është propozimi i Komisionit Evropian lidhur me Zyrën e Prokurorit Publik Evropian e deri te temat që ndërlidhen me agjencitë e mbikëqyrjes policore.

Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Fitim Shishani i cili ishte pjesëmarrës në këtë konferencë profesionale të EPAC-ut vlerësoi lart rëndësinë e shkëmbimit të përvojave në mes institucioneve të mbikëqyrjes policore të shteteve evropiane.

Në fund të konferencës, Asambleja e Përgjithshme e EPAC-ut në mënyrë unanime miratoi Deklaratën e Krakovës 2013.

Vitin e ardhshëm konferenca vjetore e EPAC-ut do të mbahet në Sofje të Bullgarisë.





# PROGRAMI I TRAJNIMIT PRAKTIK NË IPK

**P**as përfundimit të trajnimit bazik në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike (AKSP) në Vushtri, 15 zyrtarët e IPK-së kanë filluar Programin e Trajnimit Praktik. Me vendim të Kryeshefit ekzekutiv të IPK-së ishte themeluar grupi punues për përgatitjen e një Programi të tra-

jnimit fushor për zyrtarët e rinj që i bashkëngjiten IPK-së. Duke u bazuar në praktikën më të mirë grupi punues përgatiti një program që i përshtatet nevojave të Inspektoratit Policor të Kosovës. Kjo është gjenerata e parë që ka filluar me këtë program bazuar në të

cilin përcaktohen rregullat dhe procedurat e trajnimit, fazat e trajnimit, autoritetet përgjegjëse për administrimin e trajnimit, procedurat e vlerësimit, detyrat themelore, formularët e vlerësimeve etj. Trajnimi praktik zgjat 6 muaj dhe gjatë kësaj kohe zyrtarët e rinj që i



## Program për zhvillimin dhe ngritjen e standardeve profesionale për zyrtarët e rinj

nënshtrohen këtij trajnimi duhet të tregohen se kanë arritur sukses të bëhen të pavarur. Praktikantët gjatë kësaj periudhe kohore duhet të kalojnë nëpër faza të ndryshme dhe i tërë përqendrimi i tyre duhet të jetë trajnimi dhe zhvillimi i tyre profesional. Qëllimi i këtij Programi është t'i qartësojë procedurat dhe udhëzimet për trajnimin e zyrtarëve të IPK-së praktikant të posa-certifikuar në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Po ashtu si qëllim i Programit është që të lehtësojë kalimin e kandidatit nga ambienti shkollor i mësimit teorik në atë praktik ku nevojitet aplikimi i drejtpërdrejtë i aftësive gjatë kry-



erjes së detyrës, duke përfshirë këtu dy fusha të gjëra veprimi Hetimin dhe Inspektimin.

Programi ka për qëllim zhvillimin dhe ngritjen e standardeve profesionale të një udhëheqje demokratike.

Bazuar në këtë program, tashmë të miratuar nga Kryeshefi, menaxhmenti i IPK-së janë duke bërë përpjekje që t'ju ofrojnë praktikantëve njohuri të mjaftueshme për t'i kuptuar sa më mirë procedurat e punës në IPK.

Këtij programi, tash e tutje do t'i nënshtrohen të gjithë inspektorët/hetuesit e rinj të cilët e kryejnë kursin bazik në AKSP.

I tërë programi zgjat për një periudhë 6 mujore duke u ndarë në dy faza nga të cilat tetë javë janë trajnim në klasë e kombinuar me përvoja praktike në terren dhe faza e dytë që përfshin kryesisht punë praktike nga fushat e përgjegjësisë në bazë të ligjit për IPK-në.





**INTEGRITETI**

**Gëzua**

**Janar**

H	M	M	E	P	SH	D
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

**Shkurt**

H	M	M	E	P	SH	D
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28		

**Mars**

H	M	M	E	P	SH	D
						1
					2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	31

**Korrik**

H	M	M	E	P	SH	D
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

**Gusht**

H	M	M	E	P	SH	D
					1	2
					3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

**Shtator**

H	M	M	E	P	SH	D
						1
						2
						3
						4
						5
						6
						7
						8
						9
						10
						11
						12
						13
						14
						15
						16
						17
						18
						19
						20
						21
						22
						23
						24
						25
						26
						27
						28
						29
						30
						31



**RITETI**

**r 2014**



**Prill**

H	M	M	E	P	SH	D
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				

**Maj**

H	M	M	E	P	SH	D
						1
2	3	4				
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
27	27	28	29	30	31	

**Qershor**

H	M	M	E	P	SH	D
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30						

**Tetor**

H	M	M	E	P	SH	D
						1
2	3	4	5			
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		

**Nëntor**

H	M	M	E	P	SH	D
						1
2						
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30

**Dhjetor**

H	M	M	E	P	SH	D
						1
2	3	4	5	6	7	
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

# ROLI DHE MISIONI TË INSPEKTIMEVE



**Arben Vrajolli**  
Drejtor i Departamentit  
të Inspektimeve

**B**azuar në Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës, roli dhe misioni i Departamentit të Inspektimeve është që të zhvillojë inspektime ndaj Policisë së Republikës së Kosovës, të raportojë mbi punën dhe efikasitetin në arritjen e qëllimeve të menaxhmentit të saj, të japë rekomandimet e saja lidhur me efikasitetin, efektivitetin dhe pajtueshmërinë e punës policore me ligjet në fuqi.

Përmes procesit të inspektimit, Departamenti i Inspektimeve bënë vlerësimin e mënyrës së kryerjes së detyrave në Policinë e Kosovës, duke:

Përcaktuar nëse ligjet, rregulloret përkatëse dhe parimet e procedurat e Policisë së Kosovës zbatohen ashtu si

duhet dhe janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e saj;

Përcaktuar nëse burimet e policisë shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe efikase dhe se janë të përshtatshme për të arritur qëllimet dhe objektivat e saj organizative;

Parandaluar shkeljet që mund të kryhen gjatë veprimtarisë së Policisë së Kosovës;

Identifikuar mangësitë dhe duke rekomanduar masa ligjore e organizative për funksionimin më të mirë të Policisë së Kosovës;

Inspektimet të cilat i zhvillon Departamenti i Inspektimeve në IPK mund të kenë një kombinim objektivash që përfshijnë më shumë se një lloj pune inspektuese ose mund të kenë objektiva të kufizuara vetëm në disa aspekte të një lloji pune. Inspektimet fillojnë me objektiva të cilat përcaktojnë llojin e aktivitetit inspektues që duhet të kryhet dhe standardet e inspektimit që duhet të ndiqen.

Inspektorët përdorin standardet e kërkuara varësisht nga lloji i detyrës së inspektimit që kryhet.

Sipas ligjit për IPK-n një inspektim në Polici mund të fillojë, sipas iniciativës së vet IPK-së ose me urdhër të Ministrit.

Departamenti i Inspektimeve kërkon që të vërteton pajtueshmërinë e punës së policisë me Kodin Evropian të Etikës Policore si një kornizë e standardeve për kryerjen e detyrave policore në mënyrë demokratike.

Ushtrimi me sukses i këtyre autorizimeve nga IPK-ja, ka si synim

të përhershëm që t'i bind të gjitha komunitetet në Kosovë që PK-ja mund dhe do të jetë e përgjegjshme, qoftë kolektivisht apo individualisht, duke punuar në ofrimin e shërbimeve duke qenë përkrahëse për një shoqëri të sigurt dhe stabile.

Departamenti i Inspektimeve, detyrat i kryen duke u mbështetur në udhëzimin e saj administrativ i cili është i miratuar nga Ministri i Punëve të Brendshme në të cilin janë paraparë standardet e përgjithshme që kanë të bëjnë me kërkesat themelore që të sigurohet kredibiliteti i rezultateve gjatë punës së saj.

Kredibiliteti është thelbësor për inspektorët e IPK-së për kryerjen me sukses të punëve të saj mbikëqyrëse, punë në të cilën mbështetën autoritetet relevante dhe përdorues të tjerë për të marrë vendime, dhe është ajo që pret publiku nga informacioni që jepet nga inspektimet e IPK-së.

Këto standarde përfshijnë pavarësinë e inspektorëve të IPK-së, ushtrimin e gjykimit profesional në kryerjen e punës dhe në përgatitjen e raporteve përkatëse, aftësinë e stafit të inspektimeve duke përfshirë edhe nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional, si dhe ekzistencën e sistemeve të kontrollit të cilësisë.

### **Pavarësia e inspektorëve**

Në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me punën inspektuese të IPK-së, çdo inspektor duhet të mos te ketë pengesa të jashtme apo të organizatës për të qenë i pavarur në lidhje me strukturën

# I DEPARTAMENTIT TË IPK-së



e PK-së që inspektohet.

Kjo është e përkufizuar qartë në udhëzimin administrative për inspektive. Inspektorët kanë përgjegjësinë që nëse kanë ndonjë pengese personale për të qene te pavarur, të njoftojnë drejtuesit e tyre. Disa prej këtyre pengesave të inspektorëve mund të jenë: afërsia familjare me punonjësit e strukturës së inspektuar, çfarëdo interesi ndaj strukturës apo programit të inspektuar, paragjykimet, njëanshmëritë, duke përfshirë ato të nxitura nga bindjet politike, ideologjike ose sociale.

## Gjykimi profesional

Gjykimi profesional përdoret gjatë planifikimit dhe kryerjes së





inspektimeve si dhe për të raportuar rezultatet. Ushtrimi i gjykimit profesional kërkon që në të gjitha aspektet e punës së tyre, inspektorët të tregohen të kujdesshëm dhe të arsyeshëm duke zbatuar parimet e shërbimit ndaj interesit publik dhe ruajtjes së integritetit, objektivitetit dhe pavarësisë.

Drejtuesit e Departamentit të Inspektimit të IPK-së duhet ta përdorin gjykimin e tyre profesional për të përcaktuar detyrën që duhet të kryhet dhe standardet që aplikohen për punën, për përcaktimin e objektit të punës, për përzgjedhjen e metodologjisë, për përcaktimin e llojit dhe sasisë së provave që duhet të mblidhen, për zgjedhjen e testeve dhe procedurave për punën e tyre.

#### **Aftësia profesionale**

Personeli i caktuar për të kryer inspektimin duhet që kolektivisht të ketë kompetencën e duhur profesionale për të kryer detyrën. Kompetencat kanë të bëjnë me njohuritë, aftësitë dhe përvojën e IPK-se dhe jo domosdoshmërisht të secilit inspektor. IPK-ja mund të punësojë apo angazhojë në punë specialistë që kanë njohuri, aftësi e përvojë në fusha si kontabiliteti, statistika, drejtësia, inxhinieria, komunikacioni, auditivi, informatika dhe fusha tjera në interes të saj.

#### **Zhvillimi i vazhdueshëm profesional**

Inspektorët duhet të mbajnë aftësitë dhe njohuritë e tyre profesionale përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional. Ky zhvillim mund të përfshijë shumëllojshmëri temash që kontribuojnë në aftësinë e inspektorëve për të kryer inspektime. Çdo dy vjet inspektorët kryejnë të paktën 80 orë trajnime për zhvillim të vazhdueshëm profesional që drejtpërsëdrejti rrit aftësitë e tyre profesionale për të kryer inspektime. Pjesa dërmuese e orëve përfshijnë tema që lidhen me proceset dhe procedurat e inspektimit. Kontribuesi kryesor në zhvillimin profesional tash e disa vjet është ICITAP-i Amerikan të cilët kanë sjell ekspert dhe praktikant më të avancuara nga departamentet policore më të njohura botërore si Departamenti Policor i Los Angjelosit, Marina Ushtarake Amerikane, Universiteti Northwestern etj.

#### **Provat dhe vlefshmëria e tyre**

Standardet e inspektimit të IPK-së përfshijnë edhe provat që merren, të cilat duhet të jenë të mjaftueshme, të pranueshme ligjërisht dhe që kanë të bëjnë me çështjen, si dhe të përbejnë një bazë të arsyeshme për përfundimet e inspektorëve apo rekomandimet e inspektimit.

#### **Provat mund të kategorizohen si:**

a. fizike/materiale, të cilat merren nëpërmjet inspektimit të drejtpërdrejtë të inspektorëve ose nga vëzhgimi i njerëzve, pasurive apo ngjarjeve. Prova të tilla mund të dokumentohen në shkresa, fotografi, audio dhe video incizime, vizatime, grafika, harta ose mostra fizike;

b. dokumente, paraqiten si informata në formë të shkresave, kontratave, të dhëna kontabiliteti, fatura dhe informacion i drejtuesve mbi performancën;

c. dëshmi, merren përmes pyetjes, intervistimit ose pyetësorëve;

d. analitike, përfshijnë përlllogaritje, krahasime, ndarje informacioni në elemente përbërëse dhe argumente të arsyeshme.

#### **Standardet e raportimit për inspektimet**

Inspektorët përgatisin raportet e inspektimit duke pasqyruar rezultatet e çdo inspektimi. Raportet e tyre u komunikojnë autoriteteve relevante rezultatet e inspektimit, përmes tyre arrihet shmangia nga keqinterpretimet e mundshme, bëjnë rezultatet të disponueshme për publikun dhe mundësojnë përcjelljen



e vazhdueshme të veprimeve të ndërmarra korrigjuese.

Raporti i inspektimit përmban në mënyrë të qartë objektivat, objektin (thellësia e shtrirjes së punës për përbushjen e objektivave), metodologjinë (mënyrën apo teknikat e mbledhjes së provave e të analizave të tyre), rezultatet e inspektimit, përfundimet dhe rekomandimet, pikëpamjet e nëpunësve përgjegjës lidhur me rezultatet.

### **Përfundimet e Inspektimit**

Inspektoret raportojnë përfundimet duke dhënë prova të besueshme që lidhen me objektivat e inspektimit. Këto përfundime nevojitet të mbështetën nga prova të mjaftueshme, të pranueshme ligjrisht dhe që kanë të bëjnë me çështjen.

Përfundimet e inspektimit përmbajnë kriteret, kushtet, efektin, si dhe shkakun kur identifikohen probleme.

### **Përfundimet e inspektimit përfshijnë elementet e mëposhtme:**

a. Kriteret japin informacion në mënyrë që përdoruesi i raportit të mund të përcaktojë se cila është gjendja e dëshiruar apo se çfarë pritet nga programi apo veprimi.

b. Kushtet janë situata ekzistuese të cilat janë përcaktuar dhe dokumentuar gjatë inspektimit. Kushtet japin prova mbi atë që inspektorët kanë gjetur në lidhje me situatën aktuale.

c. Shkaku jep prova mbi faktorët përgjegjës për dallimin ndërmjet gjendjes së dëshiruar dhe asaj të evidentuar (kriteret dhe kushtet).

d. Efekti jep një lidhje të qartë e logjike për të përcaktuar ndikimin ndërmjet asaj që inspektorët kanë gjetur/parë (kushtet) dhe asaj që duhet të jetë (kriteret).

Inspektorët përfshijnë në përfundimet e tyre mangësitë e sistemit të



kontrollit të brendshëm ose mangësitë procedurale të konstatuara gjatë inspektimit.

Kur raportohen raste mashtrimi, abuzimi, shkelje të akteve ligjore apo të dispozitave të përgjithshme, inspektorët japin një përshkrim të punës së kryer dhe dokumentojnë këto përfundime në raportin e inspektimit.

### **Rekomandimet**

Inspektorët japin rekomandime për strukturën ose personin e inspektuar për veprimet që mund të ndërmerren për të korrigjuar problemet e identifikuar gjatë inspektimit dhe për të përmirësuar programet dhe funksionimin e tyre.

Nëse drejtuesit e strukturës së inspektuar nuk e kanë një proces, përmes të cilit marrin masa për të trajtuar përfundimet dhe rekomandimet e inspektimit apo për të ndjekur statusin e tyre, inspektorët

e përfshijnë këtë si rekomandim në raporte.

### **Nxjerrja dhe publikimi i raporteve**

Pas përpilimit të draft-raportit fillestar, ai i nënshtrohet kontrollit të cilësisë Brenda departamentit, dhe pastaj u dërgohet drejtuesve përgjegjës të strukturës së inspektuar për t'u deklaruar lidhur me të gjeturat e tij. Drejtuesit përgjegjës të strukturës së inspektuar kanë në dispozicion më së largu një muaj kohë për të dhënë komentet e tyre rreth përmbajtjes së raportit. Brenda dy muajve nga data e dorëzimit fillestar të raportit, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, raporti i nënshkruar i dorëzohet Ministrisë së MPB-së dhe Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së.

Pas tërë procesit, raporti përfundimtar publikohet në faqen zyrtare të IPK-së.



Fundi i tetorit shënoi mbajtjen e kongresit Law Tech Europe Congress 2013 në Republikën Çeke ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga Inspektorati Policor i Kosovës.



LAW TECH EUROPE

**F**undi i tetorit shënoi mbajtjen e kongresit Law Tech Europe Congress 2013 në Republikën Çeke ku pjesëmarrës ishin edhe përfaqësues nga Inspektorati Policor i Kosovës. Nga pjesëmarrësit ky kongres u vlerësua lart si për shkëmbimin e përvojave në fushën e krimit kompjuterik ashtu edhe të mundësisë së njoftimit lidhur me zhvillimet e fundit në teknologjinë informative.

Ky kongres me të drejtë shihet si vendi ku ekspertë nga fusha dhe vende të ndryshme vinë dhe diskutojnë së bashku për luftën kundër krimit kompjuterik, provat digjitale dhe rëndësia e tyre, sigurinë kibernetike etj.

Rëndësinë e këtij kongresi e shton edhe fakti se gjeneratat e sotme janë dëshmitarë të ndryshimeve të shpejta dhe të mëdha në sferën e teknologjisë informatike si dhe aplikimin e të njëjtës në automatizimin e proceseve të punës në të gjitha sferat e jetës ekonomike e shoqërore. Sot, teknologjia informatike prek çdo sferë të jetës sonë pa marrë parasysh vendndodhjen e saj në rruzullin tokësor dhe siguria kombëtare në kuptimin më të gjerë.

Këto zhvillime në masë të tillë dhe me një shpejtësi që institucionet e zbatimit të ligjit dhe sistemit të drejtësisë e kanë shpesh të vështirë që ti përcjellin, nuk kanë kaluar pa u vërejtur nga ana e një kategorie të grupeve apo individëve të papërgjegjshëm, të cilët me sjellje të kundërligjshme duke





## THE CONGRESS 2013



shfrytëzuar kompjuterin dhe komponentët e tij, ju sjellin vetes apo të tjerëve përfitime të kundërligjshme dhe njëkohësisht me veprimet e tyre iu shkaktojnë dëme materiale si personave juridik ashtu edhe personave fizik.

As Kosova sikur edhe shtetet e tjera anekënd botes nuk ka mbetur e paprekur nga ky fenomen andaj edhe pjesëmarrja në këtë kongres nga IPK-ja u pa si shumë e rëndësishme sidomos kur një nga panelistët që diskutuan në këtë kongres ishte edhe Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Fitim Shishani.

Z.Shishani në një prononcim për “Integritetin” potencoi rëndësinë e pjesëmarrjes së IPK-së në këtë kongres:

“Një rol të rëndësishëm në çështjen e sigurisë kibernetike luan edhe njoftimi me eksperiencat nga praktika e shteteve tjera siç është rasti në Law Tech Europe Congress 2013, e veçanërisht të atyre që kanë eksperiencë nga fusha e sigurisë, mbrojtjes juridike, arsimimit, etikës dhe çështjeve tjera me interes për mbrojtjen e sistemeve informatike si dhe vendosja e bashkëpunimit të ndërsjellë me organet shtetërore të shteteve tjera të cilat merren me këtë problematikë.”

# FUQIZOHET PROFESIONALIZMI NË IPK



17 zyrtarë të IPK-së vijuan trajnimin e organizuar nga ICITAP-i amerikan

**N**ë një ceremoni solemne të organizuar undanë certifikatat për të gjithë pjesëmarrësit në trajnimin e avancuar dy javor “për hetime të brendshme”.

Në këtë ceremoni përveç trajnerëve nga ICITAP-i amerikan pjesëmarrës ishin Kryeshefi Ekzekutiv i Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), z. Fitim Shishani i cili vlerësoi lart përkrahjen e ICITAP-it amerikan me këtë trajnim dhe trajnimet e tjera për pjesëtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës.

“Paanshmëria, profesionalizimi, modestia, kolegjaliteti, etika, morali dhe integriteti brenda Inspektoratit Policor të Kosovës janë vlera që duhet të jenë pikënisja për secilin pjesëtarë të IPK-së dhe trajnime të tilla do të fuqizojnë këto vlera te ju” – theksoi z. Shishani duke ju drejtuar pjesëtarëve të IPK-së.

Pjesëtarët e Inspektoratit Policor të Kosovës kanë qenë pjesëmarrës edhe në shumë trajnime të tjera të organizuara nga ICITAP-i të cilat kanë

ndikuar në ngritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të IPK-së. Ky trajnim ishte më i veçantë se trajnimet e mëhershme duke marrë parasysh edhe punën e përbashkët në terren si pjesë e fuqizimit të kapaciteteve hetuese të punonjësve të IPK-së.

Në fund të trajnimit nga IPK-ja u ndanë mirënjohje për trajnuesit nga SHBA-të për kontributin e tyre të dhënë në drejtim të ngritjes së kapaciteteve profesionale të IPK-së.





## Konferencë rajonale me zëdhënës nga sektori i sigurisë

Misioni i OSBE-së dhe Policia e Kosovës organizuan një konferencë për zyrtarët për informim të shërbimeve policore dhe agjencive mbikëqyrëse të policisë nga rajoni për t'ju ndihmuar në vendosjen e kontakteve dhe bashkëpunimit.

Pjesëmarrësit nga Prishtina, Podgorica, Shkupi dhe Tirana u takuan për herë të parë për të shkëmbyer praktikat më të mira dhe për të identifikuar fushat potenciale për bashkëpunim.

Në konferencë morën pjesë zyrtarë për informim nga zyra për informim e Policisë së shtetit të Shqipërisë, përfaqësues nga zyra e mediave e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Maqedonisë, përfaqësues nga misionet e OSBE-së në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri dhe Mal të Zi, përfaqësues nga zyra për informim e MPB-së dhe agjencive të saj si Inspektorati Policor i Kosovës, Policia e Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike si dhe përfaqësuesit nga ICITAP-i.

Në këtë konferencë tre ditore është diskutuar lidhur me format e komunikimit me media dhe publikun

në organizata prej nga vijnë përfaqësuesit shkëmbimi i përvojave dhe mundësitë e bashkëpunimit në mes organizatave policore të vendeve pjesëmarrëse. Po ashtu në kuadër të konferencës janë realizuar vizita në ambiente të ndryshme të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Kosovës, Akademisë së Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës. Konferenca ka përfunduar me konkludimin se takimet e kësaj natyre janë të domosdoshme të

realizohen edhe në të ardhmen dhe me falënderimin për OSBE-në për mbështetjen dhe realizimin e kësaj konference.





# KOMUNIKIMI STRATEGJIK PËR KOMUNIKIM TË SUKSESSHËM

**T**ransparenca njihet si parim i punës së organeve të sigurisë e në kuadër të kësaj edhe të vet Ministrisë së Brendshme dhe agjencive të saj. Komunikimi me mediat dhe fusha e marrëdhënieve me publikun shihet si fushë shumë e rëndësishme nga MPB-ja dhe agjencitë e saj. Në kuadër të kësaj, Zyra për Komunikim Publik e MPB-së në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, respektivisht, me Departamentin e ICITAP-it, organizoi një trajnim katër ditor për Komunikimin Strategjik.

Ligjëratat janë mbajtur nga specialistja amerikane për publikime dhe komunikime, Marguerite H. Sullivan. Në këtë trajnim morën pjesë zyrtarët e zyrave për informim publik të MPB-së, Inspektoratit Policor të Kosovës, Policisë së Kosovës, si dhe zyrtarët e Akademisë së Kosovës për Siguri Publike. Ky trajnim kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve në këtë fushë si dhe



## ICITAP-i përkrah MPB-në dhe agjencitë e saj me një trajnim për komunikimin

bashkëpunimin në mes të MPB-së dhe agjencive vartëse të saj. Ministri Bajram Rexhepi, me rastin e ndarjes së certifikatave për pjesëmarr-

rësit, tha se zyrat për komunikim me publikun në institucione kanë një rol të rëndësishëm që të prezantojnë punën konkrete dhe me fakte në mënyrë që qytetarët të marrin informacione saktë për punën që bëjnë institucionet në shërbim të tyre.

### Marguerite H. Sullivan

Është specialiste e punëve publike dhe komunikimeve. Ajo ka filluar karrierën si reporter dhe gazetare në vitin 1984. Ajo hyri në fushën politike më 1986, si drejtore e komunikimeve për "National Endowment For Humanitie". Më 1991 u bë anëtare e stafit të Shtëpisë së Bardhë si asistente e nën-presidentit Den Kueil. Sot është nën-presidente për komunikimet e jashtme pranë Institutit Ndërkombëtar Republikan, një organizatë private që i është kushtuar mbrojtjen së demokracisë në të gjithë botën.



Pamje nga konferenca e katërt me radhë në Maqedoni (5-7 nëntor) i organizuar nga misioni i OSBE-së dhe DCAF-i për integritetin e policisë, përgjegjshmërinë dhe mbikëqyrjen e jashtme. Në këtë konferencë pjesëmarrës ishte edhe Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, z. Fitim Shishani dhe drejtori i departamentit të hetimeve z. Jetullah Aliu.



IPK ka qenë pjesëmarrëse edhe në seminarin teknik në Slloveni (28-29 tetor 2013) të organizuar nga EPAC ku është diskutuar për rolin e përdorimit të teknologjisë informative në luftën kundër korrupsionit.



Presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, mori pjesë në inaugurimin e Shoqatës së Grave Police të Kosovës. Ajo me këtë rast tha se inaugurimi i Shoqatës e Grave të Policisë së Kosovës, është kurorëzim i punës së palodhshme dhe i vendosmërisë e përkushtimit të palëkundur, për të qenë pjesë e forumeve profesionale ndërkombëtare. Fotoja tregon pamje nga ceremonia e inaugurimit të kësaj shoqate.



Në këtë foto shihen zyrtarët e IPK-së dhe të PK-së duke diskutuar për bashkëpunimin IPK – PK gjatë veprimtarisë hetimore bazuar në ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës.

**INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS  
POLICIJSKI INSPEKTORAT KOSOVA  
POLICE INSPECTORATE OF KOSOVO**



**IPK – garancë e realizimit  
e të drejtave të qytetarëve**

**Tel: 044 192 911**

**info.ipk@rks-gov.net/ ipk.rks.net**